



Si do t'ju behet analiza?

Doktori juaj do t'ju marri nje specimen ,duke perfshire gryket nepermjet nje pjese te vogel pambuku,hunden, dhe nga saliva juaj. Specimeni do te dergohet ne laborator per te pare ne se kini coronavirusin. Rezultatet e analizes suaj do te merren brenda 24-48 oresh,dhe do t'ju telefonojne per t'ju vene ne dijeni rezultatet e analizes .Ju lutem ndigjoni me vemendje dhe ndiqni te gjitha te dhenat qe po ju jipen,njekohesisht duke ju bere te ditur rezultatet e analizes suaj.



**Azerbaijan Society
OF MAINE**

Celebrating cultural heritage

P.O. Box 8777
Portland ME 04104

AzeriSocietyofMaine@gmail.com

www.azemaine.com



Analiza e COVID-19: Cfare te kini *parasysh*



**Azerbaijan Society
OF MAINE**

Mbasi te kuni bere analizen,ndodheni para tre situatave :

1 Ne qofte se ju kishit simptoma te coronavirusit,por rezultati doli negativ:


- Do te thote qe ju nuk ishit te infektuar ne kohën kur bête analizen.
- Megjithate, ka mundesi ne disa persona kjo analize te dali negative edhe pse kane virusin.
- Kjo do te thote qe mund te kuni coronavirusin,edhe pse analiza rezultoi negative.
- Rekomandohet qe ju te rri ne shtepi 10 dite minimumin, qe nga momenti kur simptomat shfaqen, dhe gjer ne kohën qe ju nuk do te kuni temperature prej tre ditësh pa e ulur temperaturen duke perdorur ilace, dhe simptomat tuaja respiratoriale jane permiresuar.
- Telefononi doktorin tuaj ne qofte se simptomat qe kuni po keqesohen. Ne qofte se ju e ndjeni te nevojshme qe duhet te beni takim me doktorin, me pare telefononi.Nuk do te shkoni ne klinik pa biseduar me zyren e doktorit nga telefoni.



Qendro ne Shtepi
Vete-izolim



Vi Masken
ose Mbulo Fytyren



2 Ne qofte se ju kuni pasur kontakt nga afer me personin e infektuar me coronavirus dhe analiza juaj ishte negativ:

- Kjo kuptohet qe ju nuk ishit te infektuar ne kohën qe bête analizen.
- Edhe pse analiza rezultoi negative, ju vazhdoni te jini ne rrezik te madh per te pasur virusin dhe per t'ja u kaluar virusin personave te tjere.

Ju duhet te qendroni ne shtepi, dhe nuk do te shkoni ne pune gjithsejt per 14 dite qe nga dita e fundit qe ju kuni qene brenda 2 metrave nga personi qe ka coronavirus pozitiv. Ju lutem na beni te ditur ne qofte se ne duhet t'ju japim nje shkresë justifikimi per ne pune.

- Qendroni 2 metra te distancuar nga te gjithë pjestaret e tjere qe banoni ne te njejten shtepi.
- Lani duart shpesh me sapun dhe uje, dhe ne qofte se nuk kuni sapun dhe uje, perdorni disinfektant per duart qe permban te pakten 60% alcohol.

Qendra e Kontrollit te Semundjeve Maine(Maine CDC) do t'ju telefonoi t'ju pyesi ne lidhje me cdo simptom qe mund te shfaqet gjate 14 diteve. Eshte shume e rendesishme tu pergjigjeni pyetjeve nga Maine CDC nepermjet telefonit.

- Eshte shume e rendesishme qe t'i jipni informacionet e duhura CDC'se ne lidhje me personat qe ju kuni qene ne kontakt nga afer, ne menyre qe CDC'ja tu japi ndihmen e duhur personave te infektuar qe te behen mire dhe te jene jashte rrezikut nga virusi.
- Ne qofte se ju ndiheni I semure,telefononi doktorin tuaj. Mos shkoni ne zyren e doktorit tuaj pa biseduar me pare nepermjet telefonit me dike nga zyra e doktorit.
- Vini masken ne fytyre duke mbuluar hunden dhe gojen kur jini rreth pjesetareve te tjere ne shtepi, dhe kur kuni takime vizite te zyra e doktorit tuaj.

3 Analiza rezultoi pozitiv per coronavirusin: A. Duke pasur simptoma te lehta ose pa simptoma (veproni sipas te dhenave tek #2)

- Simptomave te lehta u tregohet kujdes ne shtepi.
- Ju nuk kuni nevoj per antibiotik per coronavirusin,
- .Eshte shume e rendesishme qe pjesetaret e familjes tuaj te jene te shendeteshem dhe te qendrojne jashte rrezikut, ne te njejten kohe kur ju jini I semure.
- **Te shmangni** kontaktet brenda 2 metrave me te gjithë pjesetaret e tjere qe banon ne shtepi, per te mos perhapur virusin tek pjesetaret e familjes tuaj.
- Te mbulonni fytyren kur jini rreth personave te tjere ne shtepi dhe kur shkoni tek zyra e doktorit per tu vizituar.
- Qendroni ne dhome te vecante dhe perdorni banje te vecante, ne qofte se e kuni ate mundesi,nga pjesetaret e tjere te familjes.
- Ne kohën e ngrënies duhet te rri ne vecuar dhe te hani ne dhomen tuaj.
- Ne qofte se ju kuni nje banje te perbashket me pjesetaret e tjere te familjes,duhet ta pastroni dhe ta disinfektoni ne cdo here mbasi kuni perdorur banjen.
- Lani shpesh duart me sapun dhe uje per 20 sekonda;Ne qofte se nuk kuni sapun dhe uje, perdorni solucion disinfektant per duart qe permban te pakten 60% alcohol.
- Pastroni gjithmone cdo siperfaqe qe prekni te objekteve ne shtepine tuaj.
- Ku perfshihen tavolinat,dorezat e dyerve, prizat e dritave,tavolina zyre, tualeta e banjes, dorezat e cezmes, lavomanet dhe objektet elektronike.
- Do te dilni nga shtepia vetem ne rastin kur kuni takim me doktorin.
- A nurse will call you soon to see how you are doing, and they will continue to call you until you are feeling better.
- Nje punonjes i shendetesise do t'ju telefonoi per te ditur mbi mbarevajtjen e gjendjes se shendetit tuaj, dhe vazhdimisht do t'ju marrin ne telefon derisa te ndiheni mire.
- Gjithashtu do t'ju telefonoi dhe **Maine CDC**.Eshte shume e rendesishme ti pergjigjeni telefonates se tyre.

B. Personat me simptoma shume te renda shtrohen dhe trajtohen ne spital.CDC-ja dhe Doktorët(PCP)vendosin per shtrimin tuaj ne spital.

Maine CDC Coronavirus Information:

www.maine.gov/dhhs/mecdc/infectious-disease/epi/airborne/coronavirus.shtml